




Deklaratat e analizuara:

15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




3.7 herë Rritja e Pasurisë Bruto

+ 2,650,277 Lekë Rritja mesatare e pasurisë

Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga dhe shpërblime nga funksioni	23,174,586	28.5%
Të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortes si Notere	44,013,430	54.1%
Fitimi nga shitblerja e pasurive të paluajtshme	9,782,700	12.0%
Mësimdhënia	1,261,613	1.6%
Të ardhura nga interesa bankare	3,148,654	3.9%
Total	81,380,983	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

Pa probleme.



Subjekti rezultoi me detyrime të pashlyera ndaj shoqërive të ndërtimit në shumën 2,662,340 lekë deri me datë 31.12.2017, ndërkohë që gjendja e akumuluar Cash deri në këtë periudhë është 3,916,740 lekë. Në vitin 2008, deklarohet një pagesë shtesë prej 7,460 Euro ndaj shoqërisë Union shpk, për një apartament në Tiranë me sip.69.9m2, e kontraktuar më parë me kontratë sipërmarrje- në deklaratat e mëparshme nuk rezultoi të jetë deklaruar apartament me këtë sipërfaqe dhe si rrjedhojë nuk dihet vlera e plotë e tij. Nga aktiviteti i bashkëshortes si notere, rezultoi se për vitet 2008-2013 është deklaruar xhiroja vjetore dhe shpenzime të pjesshme të aktivitetit vjetor, ndërkohë që duhej deklaruar fitimi neto vjetor.